

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)G

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator i Pergjithshem Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/01/05

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-51390-11-25-2022

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Elbasan

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

8379488

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje kancelari dhe bojera per Bashkine ,Agjencine Pyjore, SHMZSH dhe Gjendjen Civile

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/01/10

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)G

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)G

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/01/10

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/72565/12292022

30125110-530125120-830191000-4

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)G

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrateG

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit. Ğ

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 30.12.2022, ora 0800, tenderin me objekt “Blerje kancelari dhe bojëra për Bashkinë, Agjencinë Pyjore, SHMZSH dhe Gjendjen Civile”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 10.01.2023, ora 1000.

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjykojmë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

? Në kërkesat për kualifikim, kërkonte bilancet e tre viteve të fundit, duke e lënë evazive se cilat vite keni parasysh. Ju lutemi, keni parasysh se për vitin 2022, akoma nuk janë maturuar afatet e dorëzimit të bilacit financiar.

Në këto kushte, specifikoni që me “tre vitet e fundit”, keni parasysh: 2019/2020/2021.

? Jeni shprehur që vlerësimi do të bëhet sipas shumatores së çmimeve për njësi.

Bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7.3, ndryshuar me Udhëzimin e APP-së Nr.15 datë 26.11.2018, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi si mëposhtë:

Agjencia e Prokurimit Publik me datë 22.06.2020, me Nr. 3842 Prot., ka publikuar nje rekomandim mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër, nisur nga problematikat e vërejtura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë procedurave me marrëveshje kuadër ku vlerësimi ishte i bazuar tek shumatorja e çmimeve njësi.

APP rekomandon që vlerësimi bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi të bëhet vetëm në ato raste kur është e pamundur të përcaktohet sasia nga Autoriteti Kontraktor. Në procedurën që ju keni publikuar, ju keni bërë një parashikim për sasinë, pra nuk jemi në rastin kur sasia është e pamundur të parashikohet.

Ndërkohë që, sipas rekomandimit në fjalë, në të gjitha rastet e tjera, kur sasi të janë të llogaritshme në bazë të përvojave të viteve të mëparshme, siç keni përllogaritur edhe ju në këtë rast, kriteri i vlerësimit do të jetë oferta me vlerën totale më të ulët.

Kështu që nuk ka arsye të përdoret vlerësimi bazuar në shumatore.

Duke qenë se procedura është marrëveshje kuadër, ju si AK keni të drejtën ligjore për të ndryshuar sasinë, që do të blini gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër, pra nuk jeni të detyruar të përcaktoni sasinë e saktë, prandaj parashikimi që keni bërë është mëse i mjaftueshëm për të vijuar me vlerësimin bazuar në vlerën totale të ofertës dhe jo në shumatoren e çmimeve për njësi. Dhe për më tepër, sasia e parashikuar nuk ju nxjerr asnjë pengesë gjatë zbatimit të kontratave.

Në këto kushte, kërkojmë të ndryshohet mënyra e vlerësimit dhe të bëni vlerësim bazuar në vlerën totale më të ulët të ofertave, pasi siç ka vërejtur KLSH dhe siç shprehet APP në rekomandimin e saj, vlerësimi me shumatore sjell problematika të shumta.

? Në pikën 2.3.2, kërkohet: “deklarate konformiteti me standartet Europiane CE për bojrat e ofruara”

Së pari, jemi konfuz lidhur me dokumentin që duhet të paraqesë OE, në përmbushje të kësaj pike. Cila strukture e lëshon një deklaratë të tillë?? Në bazë të nenit 26/27/28 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 parashikohet se: “Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentat konkrete, që duhet të paraqesin OE për përmbushjen e këtyre kritereve”.

Theksuar kjo edhe në Udhëzimet e APP Nr. 3341/1 Prot, datë 20.03.2018, Nr.8297/Prot, datë 23.01.2020.

Kujtojmë që bojërat /tonerat, nuk bëjnë pjesë në gamën e artikujve që kanë të detyrueshme pajisjen me “deklaratë konformiteti”. Referuar edhe udhëzimeve të APP, AK nuk duhet të kërkojnë dokumenta që nuk varen nga OE, por i takojnë palëve të treta, që nuk janë pjesë e prokurimit. Kërkesat për ISO -t e produkteve, (konkretisht tonerat) janë konsideruar të padrejta për t’u kërkuar nga AK. Aq më shumë, deklaratat e konformitetit, që nuk ekzistojnë për gamën e artikujve “tonera”.

Për sa më sipër, kërkojmë të hiqet ky kriter kualifikues. pasi së pari nuk ekziston për artikujt tonera, nuk është i lidhur drejtëpërsëdrejti me objektin e prokurimit, siç e dikton Neni 30 i VKM-së, Nr.914, datë 29/12/2014, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjorisht nga grupi hartues i DST, është diskriminues dhe kufizues i konkurrencës së lirë.

? Në shtojcën e specifikimeve teknike, konstatojmë një sërë kërkesash të ekzagjeruara, që nuk janë në proporcion me procedurën e prokurimit.

1. Kërkohet: “Tonerat, duhet të jenë Origjinale/ose Ekuivalente prodhuar nga prodhuesit e pajisjeve përkatëse ose distributorë të licensuar nga prodhuesit (OEM, Genuine), jo kompatibël, jo të rimbushur, jo remanufacture.”

Lidhur me këtë kërkesë, sqarojmë se nuk ka asnjë rast, që një prodhues pajisje të licensojë një distributor për të prodhuar tonera. Nga vete fjala, “distributor” është një kompani që distribuon, pra shpërndan produktet dhe nuk prodhon. Vetë lidhja që kërkon të krijojë AK me prodhuesin e pajisjes, është në kundërshtim me LPP dhe udhëzimet e APP dhe konkretisht Udhëzimin Nr. 8297/Prot., datë 23.01.2020, ku APP shprehet qartë, që toner origjinal, konsiderohet çdo toner i prodhuar edhe nga kompani të tjera prodhuese, pa referuar asnjë lidhje me prodhuesin e pajisjes.

Kjo kërkesë kufizon konkurrencën, ju lutemi bëni korrigjimet përkatëse, në varësi me LPP dhe udhëzimin e mësipërm.

Kërkesa e AK për tonera OEM dhe jo kompatibel, është në kundërshtim me vetë kërkesën e AK, i cili pranon ekuivalencën, ashtu sikurse ia dikton edhe LPP.

Në vendimin e KPP Nr. 2450/6 Prot., date 05.01.2022, KPP shprehet qartë, që në momentin që pranohet ekuivalenca, automatikisht pranohen dhe tonerat kompatible, që s'janë gjë tjetër veçse tonera ekuivalente.

2. Kërkohet: “Tonerat/bojrat duhet të evidentohen sipas part number-it përkatës, si elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojiten”

Ndërkohë, në specifikimet teknike, në një pjesë të mirë të artikujve nuk është përcaktuar part numberi (kodi) i tonerave. Kujtojmë, që për të njëjtën pajisje, përdoren disa kode bojrash, të cilat përcaktojnë rajonin për të cilin është prodhuar pajisja, numrin e kopjeve etj.

Ju lutemi, plotësoni specifikimet teknike me kodet e bojrave, që do të pranohen nga ana juaj, duke pranuar edhe ekuivalencat e kodeve, me të njëjtin kapacitet printimi.

3. Kërkohet: “Tonerat/bojrat, duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit ”Genuine” (për bojrat të cilat prodhuesi i pajisjes me pullën e sigurisë)”.

Nuk e kuptojmë shprehjen e vendosur në kllapa.

Ju lutemi, saktësoni: “për rastet kur aplikohet nga prodhuesi i bojrave”, duke mos e lidhur me prodhuesin e pajisjes.

4. Kërkohet: “Tonerat duhet të jenë të mbështjellë me qese dhe të ambalazuara në kuti, të shoqëruara me pulla sigurie nga prodhuesi.”

Pjesa e ambalazhimit të tonerave në qese apo materiale të ndryshme polipropileni etj, nuk është në kompetencë të OE dhe nuk varet prej tij. Pulla e sigurisë, gjithashtu.

Ju lutemi shtoni “në rastet kur aplikohet nga prodhuesi”, referuar vendimit të KPP Nr. 554/3 Prot., datë 14.04.2022.

5. Kërkohet: “Modeli i printerit dhe kodi i bojës duhet të jenë të printuar në kuti dhe në etiketa që ngjiten. Numri serial i kutisë, duhet të korrespondojë me numrin serial të cardridge brenda në kuti”.

Të gjitha këto kërkesa, kanë lidhje vetëm me pamjen e jashtme të produktit dhe nuk kanë asnjë ndikim në funksionalitetin e tij. Është tërësisht jashtë mundësive të OE, të ndikojnë tek prodhuesit e pajisjeve, në mënyrën sesi do të ambalazhojnë produktet e tyre. Kërkesa që të dhënat të jenë të printuara në kuti dhe jo në etiketë është shumë e ekzagjeruar. Edhe kërkesa që modeli i printerit të jetë në kuti, është e ekzagjeruar dhe nuk ka lidhje me funksionalitetin e produktit.

Për AK është e rëndësishme që në kuti të jenë informacionet e kërkuara, pavarësisht se janë në etiketë, apo të printuara në ambalazh dhe gjithashtu, ashtu sikurse vetë AK konfirmon, është pikërisht part number-i ai që identifikon produktin dhe jo modeli i pajisjes i shkruar në kuti. I njëjti part number, përdoret për shumë pajisje dhe prodhuesit janë të lirë të shkruajnë ato modele të cilat e shikojnë të arsyeshme. Ndërkohë, vetëm part number-i, është i detyrueshëm, si elementi kryesor

identifikues.

Ju lutemi, korrigjoni kërkesën më sipër.

6. Kërkohet: “Tonerat për printera dhe fotokopje, duhet të plotësojnë sasinë e faqeve sipas data sheet-it dhe katalogut përkatës se pajisjeve.”

Pajisje të ndryshme, përdorin tonera më me shumë se një standart kapaciteti.

Ju lutemi, saktësoni, për secilën bojë, çfarë kapaciteti printimi kërkoni.

7. Kërkohet: “AK, për shkak të specifikimeve dhe funksionit sa më të mirë, mund të kërkojë vetëm tonera origjinale dhe jo ekuivalente”

Kjo kërkesë bie në kundërshtim me LPP.

Së pari, AK duhet të përcaktojë qartë në DST kërkesat e saj, cilat bojëra ka parasysh në këtë kërkesë dhe çfarë sasi? Kjo kërkesë evazive, pengon OE të kuotojnë saktë dhe në përputhje me kërkesat.

Gjithashtu, termi ekuivalent është i domosdoshëm, pasi është një kërkesë që e dikton LPP.

Ju lutemi, bëni korrigjimet përkatëse.

? Tek specifikimet teknike të letrës A4, ka problematika në kërkesa.

Kërkesat si:

1. “Brand name”: është e paqartë dhe e paargumentuar,
2. “Cilësi e parë me certifikatë Iso CIE”: është e paplotë, nuk kuptojmë çfarë është ISO CIE,
3. “Ashpërsinë në përkulje”: nuk ka një diapazon të logjikshëm, nuk është e argumentuar,
4. “Aftësinë në përkulje”: nuk ka një diapazon të logjikshëm, nuk është e argumentuar.

Elementët e sipërcituar, nuk kanë asnjë lidhje me performancën e letrës.

Kërkojmë të hiqen kërkesat e mësipërme.

? Tek kriteret për kualifikim kërkohet:

2.3.4 “Për pjesën tjetër të bojërave dhe tonerave do të sillet me katalog, i cili të ketë specifikimet e mëposhtme:

- 1-Fotografite e bojërave dhe tonerave të jenë me ngjyra, të dallueshme qartë dhe të plotësohen specifikimet teknike sipas DST -së,
- 2-Pulla e sigurisë (GENUINE),
- 3-Përshkrimi i qartë i bojës dhe tonerit,
- 4-Kodi i bojës (Part/Number),
- 5-Prodhuesi i saj. “

1. Ngjyra e fotos nuk ka asnjë ndikim në leximin e informacionit, të hiqet si kërkesë.
2. Specifikimet e vendosura në DST, mund të jenë të pasqyruara në katalog, por nuk ka asnjë mundësi, që të gjithë ato specifikime, të jenë të pasqyruara në foton e bojës.

Ju lutemi, korrigjoni piken 1, të kërkesës 2.3.4.

3. Pulla e sigurisë, duhet të specifikohet “vetëm në rastet kur aplikohet nga prodhuesi”. Nuk varet nga OE në cilën pjesë të tonerit vendoset pulla. Mund të ndodhë të mos duket në foto.

? Mostrat e kërkuara janë të ekzagjeruara dhe jo në përpjesëtim me kontratën, duke shkaktuar dëm ekonomik të panevojshëm për OE, që nuk do të jenë fitues të procedurës. Disa prej tyre, janë tonera të veçantë që do të përdreshin vetëm në këtë kontratë.

Po paraqesim këtë ankesë mbështetur në LPP, Udhëzimet e APP, duke kërkuar modifikim të disa kërkesave të tenderit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani